



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE

Nr. 4851 Prot.

Datë: 23, 04, 2024

NJOFTIM

"PËR ORGANIZMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR, BASHKIA LEZHË"

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 8, neni 23, pika 12, neni 54, shkronja "k", dhe në zbatim të ligjit Nr.69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe Projekt Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, Nr.4101 Prot, datë 15.04.2024 "Për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Lezhë", Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Projektin Bashki të Forta ka përgatitur një draft plan se si mund të përmirësohet shërbimi në arsimin parashkollor..

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit parashkollor. Plani i përmirësimit të shërbimit në arsimin parashkollor synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vision të përbashkët të fokusuar në disa objektiva strategjike, ky plan do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Lezhë nga ku përmirësohen në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor.

Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

Përmirësimi i shërbimit në kopshtet ku mungojnë regjistrimet në mënyrë që të rritet numri i fëmijëve.

Planifikim strategjik përsa i përket riorganizmit të infrastrukturës së kopshtit me qëllim përmirësimin e shërbimit në kopshte.

Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve.

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjuesën publike, ditën e hënë me datë: 13.05.2024 ora 15:00 pranë ambienteve të Bibliotekës "Gjergj Fishta" Lezhë dhe në Njësinë Adiminstrative Shënkoll, ditën e enjte me datë: 16.05.2024, ora 15:00 në sallën e mbledhjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Gjatë takimit të dëgjësës publike do bëhet prezantimi i planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor i hartuar nga Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Projektin Bashki të Forta, me qëllim arritjen e përmirësimit të shërbimit dhe infrastrukturës në kopshtet publike të Bashkisë Lezhë.

KRYETARI
Pjerin NDREU

